

	KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	<p><i>21.07.2022</i></p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="text-align: center; padding: 5px;">  </td> <td style="text-align: center; padding: 5px;"> REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA </td> <td style="text-align: center; padding: 5px;">  </td> </tr> <tr> <td colspan="3" style="text-align: center; padding: 5px;">MARRË NË DOREZIM - PRIMLJENO - RECEIVED</td> </tr> <tr> <th style="padding: 2px;">Nësja org. Org. Jedinica Org. Unit</th> <th style="padding: 2px;">Numri Broj Number</th> <th style="padding: 2px;">Shtojca Prilog Appendix</th> <th style="padding: 2px;">Vlera Vrednost Value</th> </tr> <tr> <td style="padding: 2px; text-align: center;">01</td> <td style="padding: 2px; text-align: center;">016</td> <td style="padding: 2px; text-align: center;">44016</td> <td style="padding: 2px; text-align: center;"><i>[Signature]</i></td> </tr> </table>		REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA		MARRË NË DOREZIM - PRIMLJENO - RECEIVED			Nësja org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value	01	016	44016	<i>[Signature]</i>
	REPUBLIKA E KOSOVES - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA															
MARRË NË DOREZIM - PRIMLJENO - RECEIVED																
Nësja org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value													
01	016	44016	<i>[Signature]</i>													

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitave të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 16.02.2018, lidhë këtë :

**Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi
në mes të
OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB”**

dhe
Komunës së Suharekës

**Neni 1
Objekt i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të OJQ-ve Gam Theranda, Shtëpia e Fellbahut dhe Komunës së Suharekës, të përfaqësuar nga Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës, me qëllim të financimit të projektit të Diafest 2022

**Neni 2
“ Organizimi dhe Mannifestimi i Diafest 2022”**

Kjo marrëveshje parashev vazhdimin e manifestimit tradicional të Festës së Diafestit i cili në vazhdimesi organizohet nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Suharekës të shoqëruar nga shoqëria civile, kulturore dhe nga organizata joqeveritare.

Neni

3.1 OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB” janë institucionet implementuese të këtij projekti i cili mbahet me datë 2 dhe 3 Gusht 2022.

3.2 OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB” në bashkëpunim me Komunën e Suharekës do të hartojnë agjenden e Manifestimit të Diafest 2022.

3.3 Komuna e Suharekës dhe OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB” ruajn të drejtën që të ndryshojnë përbërjen dhe përpilim e agjendës, festës, plotësimin e saj etj.

3.4 Komuna e Suharekës, Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë dhe OJQ GAM “Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB” do të menaxhoj dhe do t’i përcjell nga afér tërë aktivitet që do të zhvillohen në bazë të planit dhe veprimit të orarëve të vendosura sipas axhendës së planifikuar nga Komuna e Suharekës, Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë dhe OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB

Neni 4

4.1 OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB” do të bashkëpunojë me Drejtorinë për Kultur, Rini, Sport dhe Mërgatë të Komunës së Suharekës, me organizata dhe Institucione tjera Relevante me qëllim të realizimit sa më të mirë të projektit Diafest 2022.

Neni 5

5.1 Vlera e gjithëmbarshme e projektit për ogranizimin dhe manifestimin e Diafest 2022 është 23,450.00 Euro.

5.2 Komuna e Suharekës, do të participoj shumën prej 9,950.00 Euro.

5.3 OJQ GAM “ Theranda”, OJQ “Shtëpia e Fellbahut dhe OJQ “IVB” do të mbulojn pjesën tjetër të shpenzimeve në vlerë prej 13,500.00 Euro.

5.4 Vlera e participimit nga Komuna e Suharekës do të transferohen në llogarinë bankare të , BPB- 1301001002553238.

Neni 6

6.1 Gjatë realizimit të projektit të cekur në Nenin -1- të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit për bashkëfinancim, nga organi mbikqyrës I Komunës të cilin do të caktojë Komuna e Suharekës, gjegjësisht Kryetari dhe përfaqësuesit e OJQ-ve, do të përgatitin raport me shkrim për Komunën e Suharekës në periudhën e fillimit të manifestimit si dhe përmbylljen e e projektit duke prezantuar deftesa, përkatësisht fletëpagesa në pajtushmëri me Rregulloren financiare Nr-01/2013, nga Ministria e Financave për shpenzimin e parasë publike.

Neni 7

Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dy palëve.

Neni 8
Zgjidhja e Marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.


Neni 9
Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 15 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALËT NË MARRËVESHE



OJQ GAM Theranda

Shani SHALA
Drejtore Gjeneral

OJQ Shëpia e Fellbahut

Mejtim BYTYQI
Drejtore



OJQ IVB

Brahim Basha
Drejtues i Bashkëpunimit



Brahim Basha
Drejtues i Bashkëpunimit



Komuna e Suharekës
Bali MUHARREMAJ
Kryetari i Komunës

21 Korrik 2022
Komuna e Suharekës